



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/12  
Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet të mbledhjeve; 04, 05, 06 dhe 07 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07-P-041 të datës 08.06.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID- 19 në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e mbështet nismën legjislative nga pika 1 e këtij Vendimi.
3. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07-P-039 të datës 08.06.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin Masat e Përkohshme për ta lehtësuar efektin e Pandemisë "COVID- 19."
2. Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se çështjet të cilat synon t'i adresojë nisma e tillë legjislative do të përfshihen në kuadër të Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19, i cili shumë shpejt do të finalizohet nga Ministria e Financave dhe pas miratimit në Qeveri do t'i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/12  
Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të neneve 93 dhe 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19, 50 (2), 51 dhe 52 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohen strukturat për planifikim strategjik, respektivisht Komisioni për Planifikim Strategjik (KPS), dhe Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS).

**Komisioni për Planifikim Strategjik**

2. KPS-ja është mekanizëm që drejton procesin e Kornizës Kombëtare të Planifikimit dhe Menaxhimit Strategjik në Kosovë.
  - 2.1. Anëtarët e përhershëm të KPS-së janë:
    - 2.2.1. Kryeministri, kryesues;
    - 2.2.2. Zëvendëskryeministri i Parë, zëvendës kryesues;
    - 2.2.3. Ministri i Financave;
    - 2.2.4. Kryesuesi i GDPS-së.
  - 2.2. Kryesuesi i KPS-së mund të ftojë për pjesëmarrje në mbledhje edhe Ministrat tjerë, varësisht nga çështjet që diskutohen.
  - 2.3. Të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje të KPS-së kanë të drejtë vote, me përjashtim të Kryesuesit të GDPS-së.
  - 2.4. Në varësi prej rendit të ditës së takimit, në cilësinë e pjesëmarrësit pa të drejtë vote mund të ftohen edhe përfaqësuesit e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë relevantë.
  - 2.5. Përgjegjësitë e KPS-së janë:
    - 2.5.1. përcaktimi, propozimi dhe miratimi i prioriteteve strategjike dhe nismave të politikave të reja të Qeverisë;
    - 2.5.2. shqyrtimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe trajtimi i ngecjeve të mundshme në zbatim;
    - 2.5.3. përcaktimi, propozimi dhe miratimi i prioriteteve të SKZH;
    - 2.5.4. shqyrtimi i prioriteteve strategjike dhe propozimi për sigurimin e financimit të tyre përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe Buxhetit vjetor;

- 2.5.5. shqyrtimi dhe miratimi i prioriteteve për investime publike, Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore, dhe aplikacioneve për projekte;
  - 2.5.6. miratimi i metodologjisë për përzgjedhjen dhe prioritizimin e projekteve infrastrukturore, duke siguruar harmonizimin me Udhëzim administrativ 06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale;
  - 2.5.7. shqyrtimi dhe vendimmarrja e çështjeve të rëndësishme të sjella nga GDPS-ja.
- 2.6. KPS mund të marrë vendime mbi çështjet brenda përgjegjësive të saj, të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 2.6 të këtij vendimi.
  - 2.7. Me qëllim të zbatimit të përgjegjësive të saj, KPS mund të themelojë grupe punuese.

### Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik

- 3. GDPS është mekanizëm koordinues ndërinstitucional që mbështet KPS-në, dhe është përgjegjës për koordinimi i zhvillimit të dokumenteve kryesore strategjike, sigurimi i harmonizimit të dokumenteve strategjike dhe ndërlidhjes me burimet buxhetore, koordinimi i zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar në Kosovë, si dhe sigurimi i koordinimit dhe harmonizimit të proceseve kryesore planifikuese të Qeverisë.
  - 3.1. Anëtarët e përhershëm të GDPS-së janë:
    - 3.1.1. Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik, kryesues;
    - 3.1.2. Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (ZKM);
    - 3.1.3. Drejtori i Zyrës Ligjore (ZKM);
    - 3.1.4. Drejtori i Departamentit të Koordinimit të Procesit të Stabilizim Asociimit (ZKM);
    - 3.1.5. Drejtori i Departamentit për Asistencë Zhvillimore (ZKM);
    - 3.1.6. Drejtori i Departamentit të Buxhetit (MF);
    - 3.1.7. Drejtori i Departamentit për Politika Ekonomike dhe Publike, dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (MF);
    - 3.1.8. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, Thesari i Kosovës (MF);
    - 3.1.9. Drejtori i Departamentit për Reformën e Administratës Publike dhe Integrimi Evropiane (MPB);
  - 3.2. Kryesuesi i GDPS-së mund të ftojë për pjesëmarrje në mbledhje edhe Drejtorë tjerë të ZKM-së dhe Ministrive, varësisht nga çështjet që diskutohen.
  - 3.3. Anëtarët e përhershëm të GDPS-së mund të zëvendësohen nga zëvendësit e tyre për takime të caktuara, nëse kjo pranohet me votë nga shumica e anëtarëve të përhershëm të GDPS-së. Anëtarët e përhershëm duhet të lajmërojnë së paku 3 ditë pune më herët për pamundësinë e tyre për pjesëmarrje në mbledhje të GDPS-së.
  - 3.4. Përgjegjësitë e GDPS-së janë:
    - 3.4.1. përcaktimi dhe propozimi për miratim në KPS i prioriteteve të Qeverisë, duke i marrë parasysh edhe obligimet që dalin nga procesi i integrimit evropian;
    - 3.4.2. shqyrtimi dhe propozimi për miratim në KPS i analizave të caktuara për çështje sektoriale të cilat i paraprijnë identifikimit të prioriteteve të Qeverisë;
    - 3.4.3. shqyrtimi i koncept dokumenteve nga ministritë e linjës, sipas nevojës;
    - 3.4.4. shqyrtimi i dokumenteve strategjike, për të siguruar që të jenë në pajtim me prioritetet e Qeverisë dhe në harmoni me prioritetet e integrimit evropiane dhe KASH-in;
    - 3.4.5. vendosja e udhëzimeve të përgjithshme për hartimin e Planin e Punës së Qeverisë (PPQ) dhe shtojcave të saj;
    - 3.4.6. shqyrtimi i propozimeve për financim të donatorëve, për të siguruar që ato të jenë të ndërlidhura me prioritetet e Qeverisë dhe me planifikimit buxhetor të Qeverisë;

- 3.4.7. shqyrtimi i Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore dhe rekomandimi për miratim në KPS;
  - 3.4.8. shqyrtimi i propozimeve dhe aplikacioneve për financim të projekteve nga Lista Prioritare e Projekteve Infrastrukturore dhe rekomandimi për miratim në KPS;
  - 3.4.9. shqyrtimi i metodologjisë për përzgjedhjen dhe prioritizimin e projekteve infrastrukturore dhe rekomandimi për miratim në KPS, duke siguruar harmonizimin me Udhëzim administrativ 06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale;
  - 3.4.10. mbikëqyrja e përgatitjes së PPQ-së, përmes miratimit të dokumenteve punuese të ETSH-ve dhe draftit final të PPQ-së;
  - 3.4.11. sigurimi i funksionimit të Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik (KPMS);
  - 3.4.12. mbështet KPS-në në vendimmarrjen për planifikim strategjik dhe buxhetor;
  - 3.4.13. kryerja e detyrave tjera që lidhen me procesin e planifikimit strategjik në Qeveri, sipas kërkesës.
- 3.5. Kryesuesi i GDPS i dërgon për vendim final në KPS, të gjitha çështjet e diskutuara dhe të përgatitura në GDPS.

#### Sekretariati i KPS-së dhe GDPS-së

4. ZPS, bazuar në kërkesat dhe kontributin e njërive pjesëmarrëse në KPS dhe GDPS, dhe në bashkëpunim me to, ngarkohet me organizimin e mbledhjeve dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës sipas agjendës. Mes tjerash, ZPS-ja përgatitë konkluzionet e mbledhjeve të KPS-së dhe GDPS-së, të cilat nënshkruhen nga Kryesuesi i tyre dhe shpërndahen te pjesëmarrësit e mbledhjes, te të gjitha strukturat për planifikim strategjik të themeluara me këtë vendim, si dhe sipas udhëzimeve të Kryesuesit, u dërgohet institucioneve tjera.
5. Ministrinë mund të themelojnë struktura të ngjashme me departamentet profesionale brenda ministrisë me qëllim të sigurimit të cilësisë së vendimmarrjes dhe monitorimit të zbatimit të planeve të ministrive në kuadër të SKZH-së dhe dokumenteve të tjera strategjike sektoriale dhe ndër-sektoriale, agjendës së integritit evropian për sektorin, propozimeve për KASH-in dhe buxhet vjetorë, si dhe planet për investime publike dhe ndihmë të jashtme.
6. KPS brenda 3 muajve, nxjerr udhëzues për punën e strukturave për planifikim strategjik dhe kalendarin e integruar të planifikimit.
7. Obligohen të gjitha institucionet dhe organet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi.
8. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen këto vendime: Vendimi Nr. 11/19 i datës 18.03.2015, Vendimi Nr. 02/70 i datës 15.01.2016 dhe Vendimi Nr. 19/37 i datës 08.07.2015.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

#### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/12  
Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 paragrafi 9. të ligjit Nr. 07/L- 001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR KOMUNITETE**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i Programit për Komunitete është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve apo transfereve nga buxheti i ndarë për Zyrën për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, me qëllim të mbështetjes dhe promovimit të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Programi zbatohet nga:
  - 1.1. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në Zyrën e Kryeministrit dhe nga të gjithë personat fizikë apo juridikë të cilët janë përfitues të subvencioneve apo transfereve.
2. Buxheti i ndarë për ZÇK/ZKM për subvencionimin e mediave, personave fizikë dhe juridikë, realizohet në bazë të këtij Programi si dhe përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Buxheti i ndarë për ZÇK/ZKM për subvencionimin e OJQ-ve, realizohet në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Neni 3**  
**Parimet**

1. Gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve, duhet të respektohen parimet, si në vijim:
  - 1.1. liria e pjesëmarrjes në konkurrim;
  - 1.2. mos diskriminimi dhe trajtimi i barabartë;

- 1.3. transparenca e procedurave të vendimmarrjes, duke iu ofruar të gjithë aplikuesve të dhënat e kërkuara;
  - 1.4. përputhshmërinë me objektivat e subvencionit, me efektivitetin e përdorimit të burimeve në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kritereve, që mundësojnë vlerësimin e kërkesave apo projekt propozimeve dhe specifikave teknike e financiare për përzgjedhjen dhe shpërndarjen e subvencionit;
  - 1.5. paanshmërinë e shqyrtimit të vendimmarrjes dhe parandalimin e konfliktit të interesit;
  - 1.6. përjashtimin e mbivendosjes që nënkupton ndalimin e financimit të të njëjtit përfitues më shumë se një herë brenda një viti;
  - 1.7. ndalimi i subvencionimit të të njëjtit projekt nga organizata të tjera buxhetore apo nga donatorët e tjerë, përveç rasteve të bashkëfinancimit.
2. Gjatë zhvillimit të procedurave për financimin e projekteve për investime kapitale si dhe ekzekutimit të këtyre projekteve, duhet të respektohen parimet e parapara sipas ligjit Nr. 04/L-042 të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-92 dhe Ligjin Nr. 05/L-068, si dhe kritereve të parapara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

#### Neni 4

### MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

1. ZÇK ka të drejtë që me qëllim të realizimit të projekteve në interes të përbashkët, të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me institucionet e nivelit qendror, lokal, si dhe me organizatat tjera që zhvillojnë dhe implementojnë projekte në interes të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit do t'i specifikoj obligimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese.

#### Neni 5

### FONDI PËR MBËSHTETJEN E MEDIAVE TË KOMUNITETEVE

1. ZÇK shpallë konkurs për aplikim, me qëllim të përkrahjes financiare të mediave të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës.
2. Konkursi publik shpallet një (1) herë brenda vitit në ueb faqen e ZÇK-së, në mediat elektronike dhe të shtypura, dhe të drejtë aplikimi kanë të gjitha mediat, të cilat i plotësojnë kushtet për aplikim të përcaktuara nga ZÇK, në pajtim me këtë Program.
3. Mediat, formularët e plotësuar i dorëzojnë në ZÇK, në formë fizike apo elektronike, në njërën nga gjuhët zyrtare, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas datës së shpalljes së konkursit publik.

#### Neni 6

### Kushtet për aplikim

1. Mediat që aplikojnë në konkursin publik, duhet t'i plotësojnë kushtet, si në vijim:
  - 1.1. formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së;
  - 1.2. mediat të kenë në fushëveprimin e vet realizimin e projekteve dhe veprave përkatëse në interes të publikut dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - 1.3. certifikatën e regjistrimit të medias në organin kompetent në Republikën e Kosovës;



- 1.4. licencën për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e shërbimeve mediale audio-vizuele, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
  - 1.5. certifikatën e numrit fiskal;
  - 1.6. letërnjoftimin e vlefshëm të udhëheqësit të medias apo të personit të autorizuar, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
  - 1.7. raportin e gjashtë (6) mujorit të fundit të llogarisë bankare të medias, si dhe
  - 1.8. dokumente apo dëshmi të burimeve të tjera të financimit/mbështetjes nga donatorë të tjerë, sipas kërkesës së ZÇK-së.
2. Për produksionet e pavarura dhe mediat e shkruara nuk zbatohet pika 1.4 e këtij neni.
  3. Përveç kriterëve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, në konkursin publik ZÇK përshtatshmërisht, kërkon edhe kriteret e parapara me rregulloren e Ministrisë së Financave nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

#### **Neni 7** **Komisioni vlerësues**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozim të drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, themelon Komisionin vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të mediave për Komunitetet.
2. Për përbërjen dhe mandatin e Komisionit vlerësues vlejné përshtatshmërisht dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

#### **Neni 8** **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

1. Komisioni ka për detyrë zhvillimin e të gjitha procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga mediat, dhe bën përzgjedhjen e mediave përfituese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Program.
2. Komisioni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së mediave përfituese.
3. Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni në afat prej tri (3) ditësh njofton ZÇK-në me listën e mediave përfituese.

#### **Neni 9** **Kriteret për përzgjedhjen e mediave përfituese**

1. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së mediave përfituese, duhet t'i ketë parasysh kriteret, si në vijim:
  - 1.1. përvojën dhe kapacitetet e medias në zbatimin e projekteve paraprake;
  - 1.2. pritshmërinë dhe koston;
  - 1.3. përshtatshmërisht zbatohen edhe kriteret e parapara me Rregulloren e MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

## Neni 10

### Shpallja e mediave përfituese dhe procedura e ndarjes së mjeteve

Shpallja e mediave përfituese dhe procedura e ndarjes së mjeteve bëhet përshtatshëmrisht me Rregulloren e MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

## Neni 11

### SUBVENCIONET PËR PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË

1. ZÇK ndan subvencione për personat fizikë dhe juridikë, me qëllim të realizimit të kërkesave dhe projekteve.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozimin e ZÇK-së themelon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave dhe projekteve për ndarjen e subvencioneve për personat fizikë dhe juridikë.
3. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
4. Komisioni bën shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga personat fizikë dhe juridikë, të cilët bëjnë kërkesë në ZÇK për fitimin e subvencioneve.
5. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

## Neni 12

### Kriteret për aplikimin e personave fizikë

1. Të gjithë personat fizikë, të cilët aplikojnë për fitimin e subvencioneve në ZÇK, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret, si në vijim:
  - 1.1. formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së;
  - 1.2. arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit duke përfshirë qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara dhe ndikimin e tyre;
  - 1.3. të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - 1.4. dokumentin e vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
  - 1.5. kopjen e llogarisë bankare të njëjës nga bankat në Kosovë;
  - 1.6. dokumente tjera shtesë që dëshmojnë nevojat tjera për përfitim të subvencionit, si dhe
  - 1.7. kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.
2. Subvencionimi i personave fizikë nuk mund të tejkaloj 30% e buxhetit total të ZÇK.

## Neni 13

### Kriteret për aplikimin e personave juridikë

1. Të gjithë personat juridikë, të cilët aplikojnë për fitimin e subvencioneve në ZÇK, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret, si në vijim:
  - 1.1. formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së;
  - 1.2. të jenë të regjistruar në organin kompetent sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.3. kopjen e dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës të personit të autorizuar që përfaqëson personin juridik;
  - 1.4. kopjen e llogarisë bankare në njëjës nga bankat në Kosovë;
  - 1.5. arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit;

- 1.6. dëshminë e burimeve të tjera të financimit/mbështetjen nga donatorët e tjerë;
  - 1.7. certifikatën valide të numrit fiskal, si dhe;
  - 1.8. kushtet apo kriteret e tjera që kërkohen nga ZÇK.
2. Subvencionimi i personave juridikë nuk mund të tejkaloj 30% e buxhetit total të ZÇK.

#### **Neni 14** **Komisioni vlerësues**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozim të drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, themelon Komisionin vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të personave fizikë dhe juridikë.
2. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

#### **Neni 15** **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues**

1. Komisioni vlerësues ka për detyrë zhvillimin e të gjitha procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga personat fizikë dhe juridikë në ZÇK.
2. Komisioni mbledhet së paku një herë në tre (3) muaj për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për fitimin e subvencioneve.

### **MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

#### **Neni 16** **Monitorimi i implementimit të subvencioneve për mediat**

1. Monitorimi i zbatimit të projekteve të subvencionuara nga ZÇK bëhet përshtatshëm me Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mediat përfituese të projekteve, janë të obliguara të dorëzojnë raport narrativ në ZÇK për ecurinë e projektit, ndërsa (30) ditë pas realizimit të projektit janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi të tjera) që dëshmojnë se projekti është realizuar sipas planit dhe në pajtim të plotë me këtë Program.
3. Mediat përfituese të projekteve, me rastin e dorëzimit në ZÇK, raportit narrativ duhet t'ia bashkëngjisin edhe dokumentet, si në vijim:
  - 3.1. letërnjoftimin e vlefshëm të udhëheqësit të medias apo të personit të autorizuar, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
  - 3.2. përshkrimin në mënyrë të detajuar të projektit;
  - 3.3. fatura origjinale me numër fiskal;
  - 3.4. pagesat e kryera nëpërmjet njëres prej bankave të licencuara në Republikën e Kosovës;
  - 3.5. marrëveshjet eventuale të cilat i ka nënshkruar me ndonjë media tjetër për implementimin e projektit, si dhe
  - 3.6. dokumente të tjera të kërkuara sipas nevojës nga ZÇK.

4. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës nga përfituesi, Komisioni e njofton Drejtorin e ZÇK-së, duke rekomanduar për hapat e mëtejme.
5. Në rast të shkeljeve të kontratës apo mos dërgimit të raportit, ofruesi i mbështetjes financiare mund të nxjerr vendim për anulimin e kontratës, të kërkoj kthimin e mjeteve financiare të cilat i ka përfituar media me qëllim të realizimit të projektit. Nëse mjetet financiare nuk kthehen brenda afatit të përcaktuar nga ZÇK, bëhet iniciimi i procedurave gjyqësore.

#### **Neni 17**

#### **Monitorimi i implementimit të subvencioneve dhe transfereve për personat fizikë dhe juridikë**

1. Monitorimi i subvencioneve dhe transfereve bëhet nga Komisioni monitorues, i cili themelohet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
3. Personat fizikë dhe juridikë, përfitues të projekteve, janë të obliguar të dorëzojnë raport narrativ në ZÇK për ecurinë e implementimit të subvencionit apo transferit, ndërsa (30) ditë pas realizimit të subvencionit apo transferit, janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi të tjera) që dëshmojnë se subvencionit apo transferi është realizuar sipas planit dhe në pajtim të plotë me këtë Program.
4. Në rast se personi fizik apo juridik përfitues nuk i përmbahet kërkesave të lartcekura, vendimi do të anulohet dhe do të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike, si dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, do të kërkohet kthimi i mjeteve financiare të cilat i ka përfituar personi fizik apo juridik.

#### **Neni 18**

#### **Kontrata me përfituesin**

1. Drejtori i ZÇK-se mbi bazën e rekomandimit të komisionit vlerësues nënshkruan kontratë me shkrim me përfituesin e subvencionit/transferit, brenda 90 ditësh nga dita e mbylljes së thirrjes publike.
2. Përmbajtja e kontratës përcaktohet përshtatshëmrisht në bazë të dispozitave të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve

#### **E DREJTA PËR ANKESË**

#### **Neni 19**

#### **Komisioni i ankesave**

1. Kundër vendimit të Komisionit vlerësues për subvencionim e projekteve të komuniteteve nga ana e ZÇK, aplikantët mund të ushtrojnë ankesë tek Komisioni i ankesave.
2. Për themelimin, përbërjen, mandatin dhe procedurat e punës së Komisionit të ankesave zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e Rregullores së MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Neni 20**  
**Subjektet që nuk mund të përfitojnë subvencione**

Personat fizikë, personat juridikë, OJQ-të, mediat të cilat i shkelin obligimet ligjore të parapara me këtë Program, si dhe nuk dërgojnë raportet narrative dhe financiare, përveç masave të tjera ligjore të parapara në këtë Program, përfshihen në listën e subjekteve të cilave u ndalohet përfitimi i subvencioneve nga buxheti i ZÇK.

**Neni 21**  
**Auditimi**

1. Njësia për Auditim të Brendshëm sipas detyrës zyrtare bënë auditimin e përfituesve lidhur me shfrytëzimin racional të mjeteve financiare.
2. Njësia e Auditimit, përgatitë raportin me rekomandime, lidhur me të gjeturat e auditimit.
3. Auditimi bëhet edhe nga auditorët e jashtëm në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 22**  
**Konflikti i interesit**

1. Në rast se me ndonjërin nga anëtarët e Komisionit ekziston konflikti i interesit, në atë rast anëtari i komisionit ndërrohet dhe caktohet një tjetër anëtar, ad hoc, për procedurat e përzgjedhjes dhe votimit.
2. Të gjitha rastet e konfliktit të interesit duhet të shmangen, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**23**  
**Prioritetet e financimit**

1. Zyra për Çështje të Komuniteteve buxhetin e saj do t'a shfrytëzoj për përkrahje financiare për organizatat joqeveritare dhe mediat për realizimin e projekteve që kanë për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë.
2. Ndihmë financiare për personat në gjendje të rëndë sociale dhe për të rinjtë.
3. Financimi i aktiviteteve kulturore me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve jo-shumicë.
4. Përkrahje e bizneseve të vogla dhe të mesme.
5. Ofrimi i bursave për studentët e komuniteteve jo-shumicë.

**Neni 24**  
**Kriteret**

1. Financimi i projekteve të OJQ-ve, mediave si dhe subvencionet për personat fizikë dhe juridikë do të bëhet në përputhshmëri të plotë me dispozitat e këtij programi, duke respektuar kriteret e përcaktuara në këtë program, Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së mediave përfituese, duhet t'i ketë parasysh kriteret, si në vijim:
  - 2.1. përvojën dhe kapacitetet e medias në zbatimin e projekteve paraprake;
  - 2.2. pritshmërinë dhe koston;
  - 2.3. përshtatshmërisht zbatohen edhe kriteret e parapara me Rregulloren e MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
  
3. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personave fizik përfitues, duhet t'i ketë parasysh kriteret, si në vijim:
  - 3.1. formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së;
  - 3.2. arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit duke përfshirë qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara dhe ndikimin e tyre;
  - 3.3. të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - 3.4. dokumentin e vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
  - 3.5. kopjen e llogarisë bankare të njëjës nga bankat në Kosovë;
  - 3.6. dokumente tjera shtesë që dëshmojnë nevojat tjera për përfitim të subvencionit, si dhe
  - 3.7. kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.
  
4. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personave juridikë përfitues, duhet t'i ketë parasysh kriteret, si në vijim:
  - 4.1. formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së;
  - 4.2. të jenë të regjistruar në organin kompetent sipas legjislacionit në fuqi;
  - 4.3. kopjen e dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës të personit të autorizuar që përfaqëson personin juridik;
  - 4.4. kopjen e llogarisë bankare në njëjën nga bankat në Kosovë;
  - 4.5. arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit;
  - 4.6. dëshminë e burimeve të tjera të financimit/mbështetjes nga donatorët e tjerë;
  - 4.7. certifikatën valide të numrit fiskal, si dhe;
  - 4.8. kushtet apo kriteret e tjera që kërkohen nga ZÇK.
  
5. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personave fizikë përfitues, duhet t'i ketë parasysh kriteret, si në vijim:
  - 5.1. formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së;
  - 5.2. arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit duke përfshirë qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara dhe ndikimin e tyre;
  - 5.3. të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - 5.4. dokumentin e vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
  - 5.5. kopjen e llogarisë bankare të njëjës nga bankat në Kosovë;
  - 5.6. dokumente tjera shtesë që dëshmojnë nevojat tjera për përfitim të subvencionit, si dhe
  - 5.7. kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.
  
6. Përveç kriterëve të parapara në nenin 9, nenin 12 pika 1 dhe në nenin 13 pika 1, ZÇK kur e parasheh të nevojshme para çdo vendimi për ofrim të mbështetjes financiare, duhet të hartoj kriteret specifike varësisht nga natyra e mbështetjes financiare.

Procedura e ndarjes së subvencioneve, puna e Komisioneve vlerësuese dhe monitorimi i zbatimit të projekteve do të përcillen nga një proces transparent, i pavarur dhe i pa anshëm.

**Neni 26**  
**Ndryshimi dhe plotësimi i këtij vendimi**

Ky vendim ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës, me propozim të Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit.

**Neni 27**  
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Ndër-Ministror për Investime Strategjike ("Komisioni") për vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve për investime strategjike.
2. Komisioni përbëhet nga:
  - 2.1. Vesel Krasniqi, Ministër, MTI, kryesues;
  - 2.2. Hykmete Bajrami, Ministre, MF, anëtare;
  - 2.3. Blerim Kuqi, Ministër, MEA, anëtar;
  - 2.4. Besian Mustafa, Ministër, MBPZHR, anëtar;
  - 2.5. Enis Kervan, Ministër, MZHR, anëtar;
  - 2.6. Kryetari i komunës në të cilën realizohet investimi strategjik, anëtar;
  - 2.7. Ministri i ministrisë në të cilën realizohet investimi strategjik, anëtar;
  - 2.8. Sami Istrefi, Avokat i Përgjithshëm Shtetëror, anëtar.
3. Sipas fushës, nevojës dhe rrethanave, Komisioni mund të thërrasë në takim edhe ministri dhe organe tjera shtetërore dhe përfaqësues të grupeve të interesit.
4. Vendimet dhe rekomandimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishmëve të Komisionit, me votim të hapur.
5. Rolin e Sekretariatit të Komisionit e kryen Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve, e cila mundëson gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Komisionit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 28 dhe nenit 30 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti i konsoliduar vjetor për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Subjektet e Sektorit Publik të Kosovës për vitin 2019.
2. Obligohen të gjitha Subjektet e Sektorit Publik që të marrin masat për adresimin e çështjeve për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike si më poshtë:
  - 2.1. Rishikojnë pozitën e zyrtarit kryesor financiar sipas kërkesave të nenit 7 dhe 33 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
  - 2.2. Të siguroj pavarësinë bazuar në nenin 21 dhe 23 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe burime të mjaftueshme bazuar në nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik;
  - 2.3. Zbatojnë me kohë rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
  - 2.4. Zbatojnë llogaridhënien menaxheriale duke përfshirë delegimin e autoritetit vendimmarrës, analizën dhe menaxhimin e rrezikut bazuar në Rregulloren MF- Nr. 01/2019 për Menaxhim Financiar e Kontroll.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept dokumenti për kompensimin e viktimave të krimit.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet norma e tatimit të akcizës për mallrat si në vijim:
  - 1.1. Ujërat, duke përfshirë ujërat minerale dhe të ajrizuara të cilat përmbajnë sheqer të shtuar apo ndonjë material tjetër ëmbëltuese apo që janë me shije, si dhe pijet e tjera joalkoolike, duke mos përfshirë lëngjet e frutave apo të perimeve nga kaptina 2009, me shifër 2202, ku tarifa e taksës reduktohet në zero pikë zero zero pesë euro për një litër (0,005€/ltr); dhe
  - 1.2. Veturat dhe automjetet e tjera motorike të disenjuara për transport të personave (përpos atyre nga kaptina 8702), duke përfshirë veturat me karvan dhe veturat për gara, vetëm për veturat me shifër 870340, 87035000, 870360 dhe 8703700, ku tarifa e taksës reduktohet pavarësisht vjetërsisë në dhjetë euro (10 €) për çdo automjet.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi një (1) ditë pas konsultimit të zhvilluar me Komisionin për Buxhet dhe Financa, konform nenit 3, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit nenit 17 paragrafi 1. të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Botërore e përfaqësuar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim për financimin e projektit "Financimi i Emergjencës së Pandemisë së Kosovës".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit nenit 17 paragrafi 1. të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit "Kredia Emergjente për Infrastrukturë Vitale".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit nenit 17 paragrafi 1. të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit "Kosovë: Autostrada Kijevë - Zahaq: Financimi i rrugës dhe studimi institucional".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit nenit 17 paragrafi 1. të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Zgjatjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit "Kosovë: Projekti i Rrugëve Rajonale - Mbështetje për Njësinë Zbatuese të Projektit".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 14/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit nenit 17 paragrafi 1. të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bashkimit Evropian, e përfaqësuar nga Komisioni Evropian, e titulluar "Ndihma Makro-Financiare për Kosovën".
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/10 të datës 05.07.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë**

1. Miratohet Plani i Veprimit për testimet Covid-19.
2. Obligohen institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Plani.
3. Pjesë e këtij vendimi është Plani i Veprimit për testet Covid-19.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë